

QËLLIMI I KREDISË	Investim në pasuri të paluajtshme, për qëllime qiradhënie etj. Blerja e një banese të dytë për nevoja familjare.
SHUMA E FINANCIMIT	Deri në 60,000,000 LEK / 500 mijë Eur jo më tepër se 80% e vlerës së kolateralit
AFATI I SHLYERJES	60 muaj deri në 25 vjet
NORMA E INTERESIT	
EUR	Duke filluar nga 4.2% fiks në dy vitet e para Euribor 1V+3.7% nga viti i tretë e në vazhdim (min. 4.3%)
LEK	Duke filluar nga 4.8 % fiks në dy vitet e para Bono Thesari 1V+3.5% nga viti i tretë e në vazhdim (min. 4.8%)
KOMISIONI I DISBURSIMIT TË KREDISË	1% / 0%- blerje ose transferim kredie nga një banke tjetër 2% e shumës kur periudha deri në maturim është >1 vit
KOMISION PARAPAGIMI	1% e shumës kur periudha deri në maturim është <1 vit
PENALITET PËR VONESË PAGESE	3% në muaj mbi pjesën e papaguar
MËNYRA E PAGESËS	Këste mujore fikse (Principal+Interes)
FINANCIM KUNDREJT KOLATERALIT	Max 80% e vlerës së tregut të apartamenteve/ Max 75% e vlerës së tregut të njësive tregtare/ Max.60% të tokave truall/ Max 45% të tokave are
SHPENZIME TË TJERA	Shpenzime noterie, sigurim prone, jete, hipotekore si dhe vlerësim prone

Shënime shpjeguese:

*Afati maksimal i kredisë lidhet me kohëzgjatjen e të ardhurave të kredimarrësve.

*¹Norma e Interesit për Bonot e Thesarit 12-mujore do të jetë ajo e datës së ankandit të fundit të pasqyruar në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë. Indeksi Euribor 1V pasqyrohet në faqen zyrtare të Reuters. (Minimum është interesi kontraktor më i ulët që do të aplikohet mbi kredinë nga viti i 2/ 3-të e deri në datën e maturimit, gjatë rishikimeve të indekseve referuese të interesit).

*²Shuma minimale e lejuar për mbyllje të pjesëshme kredie do të jetë e barabartë me 6-këste mujore. Përjashtim përbëjnë rastet kur afati i mbetur i kredisë, është më i vogël se 6-muaj. Në këto raste lejohet mbyllja e totalit të kredisë. Nëse mbyllja e kredisë së klientit shoqërohet me një hapje kredie të re, atëherë komisioni i mbylljes nuk aplikohet mbi shumën e kredise që mbyllet.

*³Kërkohet sigurimi i pronës dhe i jetës së kredimarrësit kryesor për 100% të vlerës së kredisë me policë sigurimi të rinovueshme çdo vit për tepërcën e kredisë.

Për një aplikante në moshën 27 vjeçe që aplikon për kredi në vlerën 30'000 Eur afat 15 vite, norma efektive e interesit është 5.05%, kësti mujor është 222.85 Eur/muaj dhe klienti paguan në total 10,652 Eur interes.